FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 7	2002	Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8859 datë 7.3.2002	Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Europiane të investimeve për projektin e transmetim-shpërndarjes së energjisë elektrike …….	147
Ligj nr.8860 datë 7.3.2002	Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për rregullimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse për kreditë e dhëna më parë ……	151
Ligj nr.8861 datë 7.3.2002	Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Holandës për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Organizatës së Zhvillimit të Holandës (SNV) ……	159
Ligj nr.8862 datë 7.3.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", ndryshuar me ligjin nr.8444, datë 21.1.1999 …….	163
Ligj nr.8863	Për një ndryshim në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën	

datë 7.3.2002	dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjet nr.7785, datë 27.1.1994, nr.7886, datë 8.12.1994, nr.8008, datë 5.10.1995 dhe nr.8721, datë 26.12.2000 …….	164
Ligj nr.8864 datë 14.3.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për zbatimin e ligjit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës" ……...	165
Ligj nr.8865 datë 14.3.2002	Për ratifikimin e "Konventës ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit" …….	170

L I G J
Nr. 8859, datë 7.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E TRANSMETIM-SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e garancisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e transmetim-shpërndarjes së energjisë elektrike".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3266, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
GARANCIE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE

Kjo Marrëveshje është lidhur midis:
Republikës së Shqipërisë, e cila përfaqësohet në këtë Marrëveshje
nga Ministri i Financave Z. Anastas Angjeli,
Që në këtë Marrëveshje njihet "Garantuesi"
Palë e parë
dhe
Banka Europiane e Investimeve me qendër në Luksemburg,
e përfaqësuar nga Mr.Ewald Nowotny, Zëvendëspresident,
që në këtë Marrëveshje njihet "Banka"
si Palë e dytë
Ndërsa:

- Në 22 dhjetor 1999 Bordi i Guvernatorëve të Bankës, me kërkesën e Këshillit të Bashkimit Europian, vendosi të autorizojë dhënien e huave të tjera nga fondet e vetë Bankës për projektet e investimit në Shqipëri.

- Në kontratën financiare të datës 30 tetor 2001 për Projektin e "Transmetim - shpërndarjes të energjisë" (që njihet si "Kontrata Financiare") ndërmjet Bankës nga njëra anë dhe Korporatës Elektroenergjetike sh.a. (e cila njihet si "Huamarrësi") nga ana tjetër, Banka ka akorduar në favor të Huamarrësit një kredi në shumë të përbërë prej 30 000 000 (tridhjetë milion) euro, e cila do të përdoret nga Huamarrësi për një projekt rehabilitimi për uljen e humbjeve në rrjet, për të përmirësuar kapacitetin e transmetim - shpërndarjes dhe rritjen e cilësisë së furnizimit me energji.

- Qeveria e Shqipërisë është vënë në dijeni se huaja akordohet në përputhje me qëllimin e Marrëveshjes Kuadër, që përcakton veprimtaritë e Bankës në territorin e Shqipërisë, siç është rënë

dakord më 5 shkurt 1998 ndërmjet Garantuesit dhe Bankës.

- Detyrimet e Bankës, në lidhje me Kontratën Financiare, kushtëzohen nga ekzekutimi paraprak dhe lëshimi i kësaj Marrëveshjeje nga Garantuesi.

Kështu është rënë dakord si vijon:

Neni 1
Kontrata Finanaciare

1.01. Garantuesi ka dijeni për termat, kushtet dhe klauzolat e Kontratës Financiare, një kopje origjinale e së cilës e nënshkruar nga Palët i është dorëzuar.

Termat e përshkruara në Kontratën Financiare do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Garancia

2.01. Garantuesi, si detyruesi kryesor jo thjesht si garantues, garanton kryerjen e plotë dhe në kohë të të gjitha detyrimeve të pagesës së Huamarrësit kundrejt Bankës, sipas Kontratës Financiare, lidhur me principalin, interesin pa asnjë kufizim, komisionet dhe të gjitha detyrimet e tjera, shpenzimet dhe shumat, të cilat mund të lindin nga momenti në moment ose sipas ndonjë kushti të Kontratës Financiare (tani e tutje njihet si "Shumat e garantuara").

Neni 3
Zbatimi i garancisë

3.01. Kërkesa mund të bëhet në momentin që Huamarrësi nuk ka përmbushur siç duhet të gjitha detyrimet ose një pjesë të tyre të garantuara sipas nenit 2, qoftë në datën e duhur, qoftë në bazë të kërkesës për shlyerje të parakohshme ose ndryshe.

3.02. Garantuesi heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga kundërshtimet ose përjashtimet në ligj për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të kësaj Marrëveshjeje. Ai merr përsipër të përmbushë detyrimet e tij pas kërkesës me shkrim nga Banka, sa herë që të kërkohet dhe të paguajë shumat që detyrohet pa kufizim ose kusht, pa patur nevojë që Banka të dorëzojë ndonjë evidencë të veçantë në mbështetje të kërkesës së saj, përveç sa është përcaktuar në këtë Marrëveshje. Në veçanti, Banka nuk është e detyruar të provojë se ka ndërmarrë ndonjë veprim kundra Huamarrësit dhe nuk është e detyruar, para zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, të realizojë sigurimet ose të zbatojë ndonjë sigurim tjetër që Huamarrësi ose një Palë e tretë mund të ketë krijuar.

3.03. Çdo pagesë e çdo shume të garantuar nga Garantuesi do të kryhet pas pesë ditë pune nga data e kërkesës përkatëse dhe do të paguhet në monedhën e shumës së garantuar dhe në llogarinë e përcaktuar në kërkesë.

3.04. Në rastin kur Banka bën kërkesën, Garantuesi ka të drejtën t'i paguajë menjëherë Bankës, në mënyrë të detyrueshme, detyrimet e tij sipas Marrëveshjes, diferencën e Huasë së papaguar në datën e pagesës, interesin që lind deri në atë datë dhe ç'do shumë tjetër të garantuar që paguhet nga Huamarrësi, së bashku me ndonjë shumë shtesë siç përshkruhet në nënparagrafin 4.02. B të Kontratës Financiare që do të duhej të paguhej sipas Kontratës Financiare, por që Huamarrësi e ka paguar vullnetarisht para afatit sipas paragrafit 3.04.

3.05. Sipas kësaj Marrëveshjeje, garancia mbetet në fuqi deri sa të gjitha shumat e garantuara të jenë paguar në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar.

Neni 4
Anulimi

4.0.1. Kur Garantuesi i ka bërë një pagesë Bankës, për këtë shumë anulohen të drejtat dhe veprimet që Banka ka kundrejt Huamarrësit; ky veprim nuk konsiderohet në dëm të Bankës.

Neni 5
Ndryshimi i Kontratës Financiare

5.01. Sipas paragrafit 5.02, Banka mund të bjerë dakord me ndonjë ndryshim të Kontratës Financiare që nuk rrit shumat që janë për t'u paguar nga Huamarrësi. Banka do të njoftojë Garantuesin për çdo ndryshim të tillë.

5.02. Banka, në përputhje me datën e pagesës të çdo shume të garantuar, mund t'i lejojë Huamarrësit një zgjatje të kohës deri në tre muaj. Një zgjatje e tillë e kohës duhet t'i njoftohet Garantuesit.

5.03. Banka nuk mund të ndryshojë termat e Kontratës Financiare, përveç se siç janë përcaktuar në paragrafët 5.01. dhe 5.02. ose përveçse me anë të pëlqimit paraprak me shkrim të Garantuesit, pëlqim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

Neni 6
Angazhime të veçanta dhe sigurimi

6.01. Garantuesi merr përsipër të sigurojë se ndryshimet e tarifave do të zbatohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin Rregullues të Sektorit Energjetik, për të siguruar një përmbushje të kënaqshme financiare të Huamarrësit dhe për të pasqyruar koston e furnizimit me energji elektrike.

6.02. Garantuesi merr përsipër të sigurojë, herë pas here, duke përdorur të gjitha mjetet që ka në dispozicion sipas ligjit shqiptar në fuqi, (i), se të gjitha tokat që duhet të shpronësohen për punimet që do të kryhen për Projektin janë të lira dhe të vlefshme për Huamarrësin kur ky i fundit të ketë nevojë dhe (ii) se lejet e nevojshme për të tilla punime do të mundësohen në kohë nga autoritetet kompetente, pas kërkesës së Huamarrësit.

6.03. Garantuesi siguron se shumat e papaguara të Huamarrësit nga shteti dhe institucione të tjera buxhetore do të caktohen në përputhje me Planin e veprimit, i hartuar për Huamarrësin në dhjetor 2000.

Neni 7
Taksat, detyrimet dhe shpenzimet

7.01. Taksat ose detyrimet fiskale, kostot legale dhe shpenzime të tjera që lindin nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshje do të mbarten nga Garantuesi. Garantuesi do të kryejë pagesa pa mbajtje ose zbritje në llogari të taksave dhe detyrimeve fiskale.

Neni 8
Ligji dhe juridiksioni

8.01. Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga ligjet e Grand Duchy of Luksemburg.

8.02. Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me këtë Marrëveshje do t'i paraqiten Këshillit të Drejtësisë të Komunitetit Europian.

Palëve në këtë Marrëveshje u hiqet çdo imunitet apo e drejtë për të kundërshtuar juriksionin e kësaj gjykate. Një vendim i kësaj Gjykate, dhënë sipas paragrafit 8.02. është përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët, pa kufizim apo rezervim.

Neni 9
Klauzola të përgjithshme

9.01. Njoftimet dhe komunikimet e tjera që njëra Palë i dërgon tjetrës do të dërgohen në adresat e përmendura më poshtë ose në adresa të tjera sipas njoftimeve paraprake me shkrim të adresave të reja nga ana e marrësve, duke siguruar se njoftimet për Garantuesit do të dërgohen në adresën e përcaktuar në adresën e mëposhtme (1) lidhur me procese gjyqësore apo mosvazhdim, në rastin e të cilit do të dërgohen në adresën e mëposhtme (2) ku Garantuesi ka zgjedhur selinë e përhershme.

- për Garantuesin: 1. Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri
2. Misioni i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian
Rue Tenbosch 30
B-1000 Bruksel
- për Bankën1. Buleverdi Konrad Adenauer 100
L-2950 Luksemburg
9.02. Recitalet janë pjesë të kësaj Marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje në emër të tyre në katër origjinale në gjuhën angleze, çdo faqe përveç kësaj faqe është siguruar në emër të Bankës nga Zt. A. H. Brandt Corstius, këshilltar.

Tiranë, më 30 tetor 2001

Nënshkruar në emër tëNënshkruar në emër të
Republikës së ShqipërisëBankës Europiane të Investimeve
Anastas AngjeliE.Nowotny

L I G J
Nr. 8860, datë 7.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E DHËNA MË PARË

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për rregullimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse për kreditë e dhëna më parë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3267, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE
PËR RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NDAJ FERDERATËS RUSE PËR KREDITË E DHËNA MË PARË

HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse, të quajtura më poshtë Palë,

në përputhje me kushtet e Memorandumit shumëpalësh mbi reduktimin dhe ristrukturimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë (më tej quhet Memorandumi shumëpalësh), nënshkruar më 22 korrik të vitit 1998 në qytetin e Parisit nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve kreditore pjesëmarrëse të Klubit të Parisit,

duke pasur parasysh kushtet e asociimit të Federatës Ruse në veprimtarinë e Klubit të Parisit me cilësinë e shtetit kreditor me të drejta të plota,

me qëllimin e zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve,

ranë dakort për sa më poshtë:

Neni 1
Kategoritë e borxhit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të përdoren në borxhin për kreditë shtetërore me afat shlyerjeje me shumë se një vit, të cilat i janë dhënë apo garantuar nga Qeveria e ish BRSS-së ose nga institucionet e saj përkatëse Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose institucioneve të saj përkatëse ose janë mbuluar nga garancia e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose institucioneve të saj përkatëse (më tej quhen kredi shtetërore).

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në kategoritë e përmendura të borxhit, pavarësisht nga kushtet e shlyerjes të vendosura në marrëveshjet e kredive.

Neni 2
Shumat e rregulluara

1. Shuma e përgjithshme e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse, sipas principalit dhe interesave, sipas kredive shtetërore të dhëna më parë përbën shumën 142.818.499,64 rubla sipas gjendjes më 1 maj 1998.

2. E gjithë shuma e borxhit e shprehur në rubla, i nënshtrohet konvertimit në dollarë amerikanë mbi bazën e kursit zyrtar të rublës të Bankës Shtetërore të BRSS-së, që është 0,6 rubla për 1 dollar amerikan.

Duke u nisur nga kjo, shuma e përgjithshme e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse arrin shumën 238.030.832,73 USD sipas gjendjes më 1 maj 1998.

3. Shtatëdhjetë për qind e shumës së borxhit sipas principalit dhe interesave, të shprehura në USD dhe të treguara në pikën 2 të këtij neni, nuk do të paguhet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Tridhjetëpërqindëshi i mbetur i këtij borxhi do të shlyhet në përputhje me këtë Marrëveshje.

Ky reduktim fillestar i borxhit të kërkuar nga Federata ndaj Republikës së Shqipërisë do të hyjë në fuqi ligjore nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

4. Shuma e borxhit sipas principalit dhe interesave, që është objekt i kësaj Marrëveshjeje (më tej quhet shumat e rregulluara), duke përfshirë pagesat që u ka kaluar afati, tregohet në shtojcën nr.1, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje,

Neni 3
Konsolidimi

1. Pesëdhjetë për qind e shumave të rregulluara që i nënshtrohet shlyerjes sipas gjendjes më 1 maj 1998, inkluzivisht, nuk do të paguhet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Pesëdhjetë përqindëshi i mbetur i shumave të rregulluara që i nënshtrohet shlyerjes sipas gjendjes më 1 maj 1998, inkluzivisht, do të konsolidohet në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Shumat e rregulluara të konsoliduara në përputhje me pikën 1 të këtij neni (më tej quhen shuma të konsoliduara), tregohen në shtojcën nr.2, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Shlyerja e shumave të konsoliduara

Shumat e konsoliduara do të shlyhen në dollarë amerikanë, në përputhje me grafikun e parashikuara në shtojcën nr.3, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Maturimi dhe pagesa e interesave

1. Në çdo shumë të konsoliduar, të treguar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, të shprehur në dollarë amerikanë, duke filluar që nga 1 maji 1998, do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

2. Interesat do të maturohen çdo gjashtë muaj dhe do të paguhen në dollarë amerikanë, më 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti; ndërkaq pagesa e parë do të kryhet më 1 nëntor 1998, kurse pagesa e fundit do të kryhet njëkohësisht me pagesën e fundit për shlyerjen e shumave të konsoliduara.

3. Interesat do të maturohen mbi bazën e sasisë faktike të ditëve të rrjedhura gjatë vitit me 360 ditë. Ndërkohë do të përdoren kuoatat LIBOR që veprojnë dy ditë pune para fillimit të çdo periudhe përkatëse 6-mujore për llogaritjen e interesave (më tej quhet periudha e interesave).

Neni 6
Interesat për borxhin që i ka kaluar afati

Në rastin kur çdo pagesë për shlyerjen e shumave të konsoliduara dhe interesave, të treguara në nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje, nuk është kryer në afatin e caktuar, ky borxh shpallet i vonuar dhe për të maturohen interesa sipas kuotës LIBOR, që vepron në periudhën e interesave korresponduese plus marzhin në masën katër për qind në vit, nga data e krijimit të borxhit të vonuar deri në datën e shlyerjes së plotë të kësaj pjese të borxhit, inkluzivisht.

Neni 7
Agjentët/procedurat

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Veprimtarisë së Jashtme Ekonomike e BRSS-së (që më tej quhet "Vneshekonombank") janë agjentë të plotfuqishëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse, përkatësisht. Për qëllime të realizimit të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha pagesat për shlyerjen e borxhit sipas principalit dhe interesave do të bëhen nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, për llogari të Ministrisë së Financave të Federatës Ruse në "Vneshekonombank", sipas kërkesës së kësaj të fundit. Rregulli i llogaritjes dhe kalkulimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të përcaktohet në marrëveshjen përkatëse midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe "Vneshekonombank".

Neni 8
Kushtëzimi

Në rast se Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të plotësojë kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të Memorandumit shumëpalësh, mbi çka Kryetari i Klubit të Parisit paraprakisht lajmëron Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, kushtet e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje ndërpresin veprimin e tyre dhe do të shpallen të paqena, ndërsa borxhi i konsoliduar, në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me interesat e maturuara në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje, do të shpallen në afat shlyerjeje (duke marrë parasysh pagesat për principalin dhe interesat, të cilat tashmë janë kryer), me përjashtim të pagesave, afatet e shlyerjes së të cilave, të

përcaktuara në marrëveshjet e kredive origjinale, ende nuk kanë mbërritur.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit mbi kryerjen e procedurave të brendshme shtetërore, të domosdoshme për hyrjen e saj në fuqi dhe e ndërpret veprimin e saj nga data e plotësimit të plotë nga Pala Shqiptare të detyrimeve që ajo ka sipas kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Moskë më 26 nëntor 2001 në dy kopje, secila në gjuhën shqipe dhe ruse, duke pasur të dy tekstet juridike të barabartë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E FEDERATËS RUSE

SHTESË
PËR MARRËVESHJEN MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse, të quajtura më poshtë Palë, në përputhje me kushtet e Memorandumit shumëpalësh për reduktimin dhe ristrukturimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë (më tej quhet Memorandum shumëpalësh), nënshkruar më 14 tetor 1999 në Paris nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve kreditore, pjesëmarrës të Klubit të Parisit, ranë dakort të bëjnë ndryshimet e mëposhtme në Marrëveshjen midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse mbi rregullimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse për kreditë e akorduara më parë, datë 26 nëntor 2001 (më tej quhet Marrëveshje).

Neni 1
Konsolidimi

Në përputhje me këtë Shtesë do të konsolidohen kategoritë e mëposhtme të borxhit (më tej quhen shumat e konsoliduara sipas Shtesës).

1. Interesat e maturuara mbi shumat e konsoliduara, në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes (duke përfshirë interesat për pagesat që u ka kaluar afati të maturuara në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes), që i nënshtrohen shlyerjes sipas gjendjes më 31 Mars 1999 dhe që nuk janë paguar.

2. Interesat e maturuara mbi shumat e konsoliduara në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes (duke përjashtuar interesat për pagesat që u ka kaluar afati, të maturuara në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes), që i nënshtrohen shlyerjes nga 1 prilli 1999 deri 30 qershor 2000 dhe që nuk janë paguar.

Neni 2
Shlyerja e shumave të konsoliduara sipas Shtesës

Shumat e konsoliduara sipas Shtesës do të shlyhen në dollarë amerikanë me dhjetë pagesa të barabarta 6-mujore, ndërsa pagesa e parë do të kryhet më 30 qershor 2001 dhe pagesa e fundit më 31 dhjetor 2005.

Neni 3
Maturimi dhe pagesa e interesave

1. Për çdo shumë të konsoliduar sipas Shtesës, të paraqitur në pikën 1 të nenit 1 të kësaj Shtese, duke filluar nga 1 prilli 1999, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR

për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

Për çdo shumë të konsoliduar sipas Shtesës, të paraqitur në pikën 2 të nenit 1 të kësaj Shtese, duke filluar nga data e pagesës e përcaktuar nga nenet 4 dhe 5 të Marrëveshjes, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6 - mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

2. Interesat e treguara në pikën 1 të këtij neni, që janë maturuar nga data 1 prill 1999 deri 30 qershor 2000, do të konsolidohen dhe paguhen në përputhje me grafikun e treguar në nenin 2 të kësaj Shtese.

3. Në interesat e konsoliduara të treguara në pikën 2 të këtij neni, duke filluar nga 1 korrik 2000, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

4. Interesat e treguara në pikën 1 dhe 3 të këtij neni, me përjashtim të atyre të treguara në pikën 2 të këtij neni, do të paguhen në dollarë amerikanë më 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti dhe pagesa e parë e interesave do të kryhet më 30 qershor 2001, kurse pagesa e fundit do të kryhet njëkohësisht me pagesën e fundit për shlyerjen e shumave të konsoliduara sipas Shtesës.

5. Interesat do të maturohen mbi bazën e sasisë faktike të ditëve të rrjedhura gjatë vitit me 360 ditë. Në këtë rast, do të përdoren kuotat LIBOR që veprojnë dy ditë pune para fillimit të çdo periudhe përkatëse 6-mujore për llogaritjen e interesave (më tej quhet periudha e interesave).

Neni 4

Interesat për borxhin që i ka kaluar afati

Në rast se çdo pagesë për shlyerjen e shumave të konsoliduara sipas Shtesës dhe pagesa e interesave, të parqitura në nenin 3 të kësaj Shtese, nuk kryhet në afatet e përcaktuara, ky shpallet borxh që i ka kaluar afati dhe mbi të maturohen interesa sipas kuotës LIBOR, që vepron në periudhën përkatëse të interesave plus marzhin në masën katër për qind në vit, që nga momenti i krijimit të borxhit që i ka kaluar afati deri në datën e shlyerjes së plotë të kësaj pjese të borxhit, inkluzivisht.

Neni 5

Ruajtja e të drejtave

Kjo Shtesë është pjesë e pandarë e Marrëveshjes. Dispozitat e Marrëveshjes do të ruajnë fuqinë e tyre për pjesën që nuk është ndryshuar nga kjo Shtesë.

Termat e përcaktuara në Marrëveshje bartin po atë kuptim si dhe në këtë Shtesë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Shtesë hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit mbi kryerjen e procedurave të brendshme shtetërore, të domosdoshme për hyrjen e saj në fuqi dhe e ndërpret veprimin e saj nga data e plotësimit të plotë nga Pala Shqiptare të detyrimeve që ajo ka sipas kësaj Shtese.

Në qoftë se ndonjë pagesë e parashikuar nga kjo Shtesë duhet të ishte kryer para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Shtese, pagesa e përmendur (duke përjashtuar interesat për vonesat e maturuara, në përputhje me nenin 4 të kësaj Shtese), do të kryhet në datën më të afërt pasardhëse të parashikuar nga kjo Shtesë, por në çdo rast jo më vonë se 31 dhjetor 2001.

Bërë në Moskë më 26 nëntor 2001, në dy kopje secila në gjuhën shqipe dhe ruse, duke patur dy tekstet fuqi juridike të barabartë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E FEDERATËS RUSE

SHTOJCA NR.1

E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË

FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Shumat e borxhit të rregulluar të Republikës së Shqipërisë për kreditë e akorduara më parë sipas gjendjes më 1.5.1998

Data e Marrëveshjes së kredisë	Numri i llogarisë së kredisë	Madhësia e borxhit (në valutën e kredisë)	Madhësia e borxhit (USD)	Madhësia e shumave të rregulluara (USD)
21.07.54	128	3 983 207,11	6 638 678,52	1 991 603,56
18.07.55	163	1 408 506,73	2 347 511,22	704 253, 37
23.03.56	187	11 952 463,57	19 920 772,62	5 976 231,79
26.06.56	194	21 661 666,72	36 102 777,87	10 830 833,36
17.04.57	223	11 092 854,02	18 488 090,03	5 546 427,01
22.11.57	237	63 733 890,91	106 223 151,52	31 866 945,46
06.02.59	275	13 968 750,00	23 281 250,00	6 984 375,00
03.07.59	283	11 853 754,33	19 756 257,22	5 926 877,17
25.07.59	286	3 163 406,25	5 272 343,75	1 581 703,13
Gjithsej		142 818 499,64	238 030 832,75	71 409 249,85

GJITHSEJ: 71 409 249,85

SHTOJCA NR.2
E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Shumat e borxhit të konsoliduar të Republikës së Shqipërisë për kreditë e akorduara më parë sipas gjendjes më 1.5.1998

Data e Marrëveshjes së kredisë	Numri i llogarisë së kredisë	Madhësia e borxhit (në valutën e kredisë)	Madhësia e borxhit (USD)	Shumat e borxhit të rregulluar (USD)	Shumat e borxhit të konsoliduar (USD)
21.07.54	128	3 983 207,11	6 638 678,52	1 991 603,56	995 801,78
18.07.55	163	1 408 506,73	2 347 511,22	704 253,37	352 126,69
23.03.56	187	11 952 463,57	19 920 772,62	5 976 231,79	2 988 115,90
26.06.56	194	21 661 666,72	36 102 777,87	10 830 833,36	5 415 416,68
17.04.57	223	11 092 854,02	18 488 090,03	5 546 427,01	2 773 213,51
22.11.57	237	63 733 890,91	106 223 151,52	31 866 945,46	15 933 472,73
06.02.59	275	13 968 750,00	23 281 250,00	6 984 375,00	3 492 187,50
03.07.59	283	11 853 754,33	19 756 257,22	5 926 877,17	2 963 438,59
25.07.59	286	3 163 406,25	5 272 343,75	1 581 703,13	790 851,57
Gjithsej		142 818 499,64	238 030 832,75	71 409 249,85	35 704 624,95

GJITHSEJ: 35 704 624,95

SHTOJCA NR.3
E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Grafik
i shlyerjes së shumave të konsoliduara të borxhit

Nr.	Pjesa e principalit	Shuma e pagesës në		Data e pagesës	Nr	Pjesa e principalit	Shuma e pagesës në USD		Data e pagesës
		Principali	Interesat				Principali	Interesat	
1	0.00	0.00	1425705.51	01.11.98	2	0.00	0.00	1251612.13	01.05.99
3	0.00	0.00	1288381.56	01.11.99	4	0.00	0.00	1468196.49	01.05.00

5	0.00	0.00	1568504.17	01.11.00	6	0.00	0.00	1561779.80	01.05.01
7	0.00	0.00	1142161.20	01.11.01	8	0.00	0.00		01.05.02
9	0.00	0.00		01.11.02	10	0.00	0.00	-	01.05.02
11	0.00	0.00	-	01.11.03	12	0.00	0.00	-	01.05.04
13	0.12	42845.55	-	01.11.04	14	0.20	71409.25	-	01.05.06
15	0.28	99972.95	-	01.11.05	16	0.38	135677.58	-	01.05.06
17	0.48	171382.2	-	01.11.06	18	0.58	207086.83	-	01.05.07
19	0.70	249932.38	-	01.11.07	20	0.82	292777.93	-	01.05.08
21	0.94	335623.47	-	01.11.08	22	1.08	385609.95	-	01.05.09
23	1.22	435596.42	-	01.11.09	24	1.36	485582.90	-	01.05.10
25	1.52	542710.30	-	01.1.10	26	1.70	606978.62	-	01.05.11
27	1.86	664106.02	-	01.11.11	28	2.06	735515.27	-	01.05.12
29	2.26	806924.52	-	01.11.12	30	2.46	878333.77	-	01.05.13
31	2.68	956883.95	-	01.11.13	32	2.92	1042575.05	-	01.05.14
33	3.18	1135407.07	-	01.11.14	34	3.44	1228239.10	-	01.05.15
35	3.70	1321071.12	-	01.11.15	36	4.00	1428185.00	-	01.05.16
37	4.30	1535298.87	-	01.11/16	38	4.64	656694.60	-	01.05.17
39	4.98	1778090.32	-	01.11.17	40	5.34	1906626.97	-	01.05.18
41	5.72	2042304.55	-	01.11.18	42	6.12	2185123.05	-	01.05.19
43	6.54	2335082.47	-	01.11.19	44	7.00	2499323.75	-	01.05.20
45	7.46	2663565.02	-	01.11.20	46	7.96	2842088.15	-	01.05.21

35704624.95 9706340.86

(-) Interesat llogariten kur fillon periudha përkatëse e interesave.

L I G J
Nr. 8861, datë 7.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË HOLANDËS PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS SË ZHVILLIMIT TË HOLANDËS (SNV)

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Holandës për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Organizatës së Zhvillimit të Holandës (SNV)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3268, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË MBRETËRISË TË HOLANDËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË PËR BASHKËPUNIMIN E QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS SË ZHVILLIMIT TË HOLANDËS SNV

- Qeveria e Mbretërisë së Holandës, këtu më poshtë referuar si Pala Holandeze,
- Qeveria e Republikës së Shqipërisë, këtu më poshtë referuar si Pala Shqiptare,

Duke dëshiruar të nxisin mirëkuptimin reciprok dhe marrëdhëniet miqësore midis dy popujve për të ndihmuar në proceset e zhvillimit,

Ranë dakort si më poshtë:

Neni 1

1. Pala Holandeze do të sigurojë fonde dhe personel të përqendruar, veçanërisht por jo ekskluzivisht në fushat e mëposhtme:

a) të rrisin fuqinë sociale dhe ekonomike të grupeve të varfëra dhe njerëzve të prapambetur të popullsisë shqiptare;

b) të asistojë sipërmarrjet e reja veçanërisht në zonat bujqësore, duke u përqendruar në kualifikimin, zgjerimin, marketingun, kreditin dhe planifikimin;

c) të asistojë për grupet sociale të cenuara të popullsisë.

2. Pala Holandeze do t'i besojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Organizatës së Zhvillimit të Hollandës SNV, që më poshë referuar si SNV.

3. Pala Shqiptare do t'i besojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë së Shqipërisë, që më poshtë referohet si Ministri.

4. Rregullime administrative të veçanta mund të bëhen midis Ministrisë dhe SNV-së me qëllim, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Këto rregullime, ku midis të tjerave edhe kushtet materiale (si p.sh. akomodimi, dokumentet zyrtare etj), që influencojnë në punësimin e personelit të SNV-së, duhet të bëhen paraprakisht.

Neni 2

1. Me qëllim që SNV-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet të cilat ajo ka marrë përsipër, Pala Shqiptare bie dakord me emërimin e personelit të SNV-së, i cili përfshin edhe Drejtorinë e Vendit si përfaqësues të SNV-së, stafin e SNV-së dhe punonjës të zhvillimit të SNV-së.

2. Pala Shqiptare do të ndihmojë personelin e SNV-së në përputhje me legjislacionin shqiptar, me qëllim që ato të mund të kryejnë në mënyrë të kënaqshme detyrat që u janë ngarkuar atyre.

3. Personeli i SNV-së do të respektojë legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

4. Përfaqësuesve të Palës Holndeze ose të SNV-së, në konsultim me Palën Shqiptare, do t'i jepet mundësia të njihen në vend me progresin e aktiviteteve, në të cilat SNV-ja ose personeli i ngarkuar i SNV-së janë duke kryer.

Neni 3

1. Pala Holandeze rezervon të drejtën për të tërhequr anëtarët e personelit të SNV-së pas konsultimit me Ministrinë. Një masë e tillë do të zbatohet duke mos krijuar vështirësi për zbatimin e projektit ose programit për të cilin anëtari i personelit të SNV-së është punësuar.

2. Pala Shqiptare rezervon të drejtën t'i kërkojë Palës Hollandeze të tërheqë një anëtar të personelit të SNV-së nëse sjellja e tij personale ose profesionale përbën bazën për të vepruar kështu. Pala Shqiptare do t'i japë vetes së saj këtë të drejtë vetëm pas paraqitjes së pakënaqësisë autoriteteve kompetente të Holandës dhe duke shqyrtuar mundësinë e vendojes së individit në fjalë në një post tjetër, nëse një mundësi e tillë ekziston dhe duke konsideruar arsyet që theksohen në kërkesë.

Neni 4

Pala Holandeze:

1. do të paguajë paga holandeze për personelin joshqiptar të SNV-së;

2. do të paguajë të gjithë shpenzimet e zyrave;

3. do të paguajë të gjitha shpenzimet për punën dhe kualifikimin e paracaktuar;

4. do të sigurojë personelin e SNV-së me të gjithë stafin dhe burimet materiale të cilat ajo i gjykon të nevojshme për shpërndarjen eficente të detyrave të tyre, për aq sa këto burime nuk janë siguruar në fondet e caktuara për aktivitetin. Burimet materiale (përfshirë pasurinë e patundshme) janë paracaktuar për shërbime publike të Holandës dhe do të qëndrojnë pronë e Palës Holandeze. Me përfundimin e aktivitetit autoritetet kompetente mund të vendosin në konsumim për t'i caktuar ato për një përdorim tjetër ose për të transferuar pronësinë.

Neni 5

Pala Shqiptare:

1. do t'i sigurojë personelit joshqiptar të SNV-së të gjitha lehtësitë e mundshme për asistencë në pajtim me rregullat doganore që kanë të bëjnë me zhdoganimin e artikujve të përmendura në nenin 4 dhe për rregullimin e shkarkimit dhe depozitimin e përkohshëm të këtyre artikujve në pikën e hyrjes në Shqipëri;

2. do të përjashtojë personelin joshqiptar të SNV-së, anëtarët e familjes së tyre dhe/ose vartësit nga pagesa e taksave të importit dhe taksave doganore mbi pasurinë personale të re ose të përdorur dhe pajisje profesionale;

3. do të përjashtojë Palën Holandeze nga të gjitha taksat e importit dhe taksat doganore dhe nga të gjitha taksat e tjera mbi artikujt, duke përfshirë automjetet dhe furnizime të tjera të bëra nga Pala Holandeze ose nga SNV-ja me qëllim zbatimin e projekteve dhe programeve të përfshira sipas kësaj Marrëveshjeje;

4. do të heqë çdo taksim mbi pagat dhe shpërblimet të cilat personeli joshqiptar i SNV-së merr për shërbimet e tij nga Pala Holandeze; Subjektet që sipas rregullave në fuqi janë me qëndrim jo të përhershëm; Pala Shqiptare do të ofrojë për personelin joshqiptar të SNV-së, në përputhje me legjislacionin shqiptar lehtësira këmbimi, të cilat janë sa më të favorshme për transferimin e fondeve nga/dhe në Holandë.

5. do të pajisë personelin joshqiptar të SNV-së, anëtarët e familjes së tyre dhe/ose vartësit me të gjitha dokumentet e identitetit të kërkuara, me qëllim që të sigurojë bashkëpunimin e autoriteteve lokale në zbatimin e detyrave të tyre;

6. do të pajisë me viza hyrje dhe dalje në çdo kohë pa pagesë kur kërkohet nga SNV-ja.

7. do të përjashtojë personelin joshqiptar të SNV-së, anëtarët e familjes së tyre dhe/ose vartësit nga pagesa e taksave dhe të gjitha detyrimeve të tjera që lidhen me vizat e emigrimit;

8. do të përjashtojë personelin joshqiptar të SNV-së, anëtarët e familjes së tyre dhe/ose vartësit nga të gjitha format e shërbimit kombëtar.

Neni 6

Pala Shqiptare:

1. do të përjashtojë personelin e SNV-së nga persekutimi mbi bazën e ndonjë fjale të folur ose të shkruar ose veprimi të personelit të SNV-së në cilësinë e tyre zyrtare;

2. do të përjashtojë Palën Holandeze, SNV-në dhe personelin e SNV-së nga çdo përgjegjësi jokontraktualisht e ligjshme që rrjedh nga një veprim ose mosveprim i një pjese të një ose më shumë personave të përmendur në këtë Marrëveshje, i cili rezulton në vdekjen ose në dëmtimin fizik të Palëve të treta ose në dëmtime materiale, për aq sa këto raste nuk janë mbuluar nga siguracioni; Pala Shqiptare ka të drejtë për të bërë çdo reklamim ose procedurë institucionale mbi bazën e mbështetjes jokontraktuale, përderisa një mbështetje e tillë është rezultat i një gabimi me dashje ose neglizhence të rëndë.

3. në rast se përjashton Palën Holandeze SNV dhe personelin e SNV-së në lidhje me çdo reklamim ose procedurë institucionale në fushën e përgjegjësisë jokontraktualisht të ligjshme në pajtim me paragrafin e lartpërmendur, ajo ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat për të cilat Pala Hollandeze SNV dhe personeli i SNV-së mund të reklamojë;

4. me kërkesë të Palës Shqiptare, Pala Holandeze do të sigurojë autoritetet kompetente të Shqipërisë me asistencë administrative dhe ligjore, me qëllim që të arrihej zgjidhja e kënaqshme e problemeve, të cilat mund të rrjedhin nga zbatimi i paragrafëve të lartpërmendura të këtij neni.

Neni 7

Shkalla e mbrojtjes dhe masa e privilegjeve të ofruara nga Pala Shqiptare do të jetë të paktën e barabartë me mbrojtjen dhe privilegjet e ofruara për personelin e çdo vendi tjetër ose organizate ndërkombëtare, të cilët janë duke vepruar në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim, nëpërmjet të cilit një bashkëpunim i tillë është vendosur në një marrëveshje detyruese sipas ligjeve ndërkombëtare.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet provizorisht pas nënshkrimit dhe do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Holandës të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim se kërkesat ligjore të aplikueshme në secilën vend janë zbatuar.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 3 vjetësh dhe mundet më pas të shtyhet pa lajmërim për të njëjtën periudhë, përveç se kur një Palë informon Palën tjetër për vendimin saj për ta përfunduar atë. Ky vendim duhet të shpallet të paktën 6 muaj para mbarimit të kësaj periudhe.

3. Përsa i përket Mbretërisë së Holandës, kjo Marrëveshje do të zbatohet vetëm brenda territorit europian të Mbretërisë.

Plotfuqishmëria e nënshkruar e cila autorizon nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në dy kopje, në gjuhët shqipe, holandeze dhe angleze në Tiranë më datë 27 të muajit gusht të vitit 1994. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti anglisht do të vlerësohet si referues.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Mbretërisë së Hollandës

L I G J
Nr. 8862, datë 7.3.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7995, DATË 20.9.1995 "PËR NXITJEN E PUNËSIMIT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8444, DATË 21.1.1999

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", ndryshuar me ligjin nr.8444, datë 21.1.1999, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 5 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

"5. Politikat shtetërore të punësimit vendosen nga Këshilli i Ministrave. Ministria nxit dhe realizon zbatimin e politikave për punësimin, arsimimin dhe formimin profesional nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit.".

Neni 2

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik, autonom, me statusin e një administrate shtetërore, qendrore, që përgjigjet para ministrit.

2. Organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Këshilli Administrativ Tripalësh. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

3. Autoriteti më i lartë ekzekutiv i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përkatës.".

Neni 3

Shkronja "b" e pikës 2 dhe pika 3 e nenit 18 shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3269, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8863, datë 7.3.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 "PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7785, DATË 27.1.1994, NR.7886, DATË 8.12.1994, NR.8008, DATË 5.10.1995 DHE NR.8721, DATË 26.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjet nr.7785, datë 27.1.1994, nr.7886, datë 8.12.1994, nr.8008, datë 5.10.1995 dhe nr.8721, datë 26.12.2000, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Në zbatim të këtij ligji krijohet Shërbimi Social Shtetëror, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm i këtij shërbimi.

Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Shërbimit Social Shtetëror, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Administrativ dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të tij.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3270, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8864, datë 14.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR ZBATIMIN E LIGJIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për zbatimin e ligjit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, nënshkruar në Tiranë më 10.1.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3271, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
PËR ZBATIMIN E LIGJIT MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

I.Të përgjithshme

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Zëvendëskryeministri Skënder Gjinushi dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (QSHB), e përfaqësuar nga e Ngarkuara me Punë e Ambasadës Amerikane Elizabeth W. Shelton, kanë rënë dakord së bashku për të ngritur dhe mbështetur një projekt të hartuar për të nxitur zbatimin e ligjit në Shqipëri.

Aksionet që do të ndërmerren dhe burimet që do të ofrohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe QSHB-ja në mbështetje të këtyre projekteve që jepen më poshtë pranohen nga nënshkruesit si angazhime solide, përveçse në rastet kur u bëhen amendamente me marrëveshje të përbashkët. Asistenca totale e SHB-së është US$ 4, 758, 062, që përfshin asistencën teknike dhe trainimin e kontraktuar nëpërmjet agjencive të QSHB-së. Financimi i mëtejshëm për këto projekte varet nga autorizimi i kongresit dhe dhënia e fondeve dhe aprovimi i tyre nga Asistentsekretari i Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjeve dhe Narkotikëve.

Modifikimi i kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet siç mund të bien dakord së bashku nënshkruesit dhe mund të shtohen si amendamente të Marrëveshjes.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Zëvendëskryeministri Skënder Gjinushi dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (QSHB), e përfaqësuar nga e Ngarkuara me Punë e Ambasadës Amerikane Elizabeth W. Shelton, janë dakord për të mbështetur të gjitha kushtet e kësaj Marrëveshjeje nga data e nënshkrimit deri në fund të saj, përveç se kur kjo marrëveshje është amenduar nga të dy Palët.

II. Përshkrimi i projektit

Ky projekt është hartuar për të ngritur mundësitë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të nxitur dhe mbështetur zbatimin e ligjit. Për këtë qëllim QSHB-ja dhe Qeveria e Rpublikës së Shqipërisë do të marrin veprime dhe do të ofrojnë burime mbi baza vjetore të autorizuara nga proceset e tyre respektive e legjislative për të mbështetur këtë përpjekje.

Aksionet që do të ndërmerren, përfshijnë asistencën teknike, trainim, dhe dhënien e kufizuar të pajisjeve:

1. për të rritur kapacitetet e policisë kufitare;

2. për të ndihmuar për të zhvilluar procedurat dhe funksionimin efektiv të sektorit të krimit të organizuar të Policisë së Shtetit Shqiptar (PSH) dhe, në veçanti, të degës së anti-trafikut, si edhe Qendrën Anti-Trafik në Vlorë në momentin e ngritjes;

3. për të ndërtuar komponentët fillestarë të një sistemi të përgjithshëm të manaxhimit të informacionit (SPMI);

4. për të ndihmuar PSH-në në hartimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe auditimin;

5. për të zgjeruar dhe profesionalizuar edhe më shumë Zyrën e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Shtetit;

6. për të rritur kapacitetet e Akademisë së Policisë, duke përfshirë edhe zhvillimin e instruktorëve;

7. për të zhvilluar edhe më tej stafin menaxherial dhe kontrollues të PSH-së; dhe

8. për të vazhduar rritjen e kapaciteteve të planifikimit strategjik të Ministrisë së Rendit dhe PSH-së;

9. për të ndihmuar për të zhvilluar një task forcë kundër krimit të organizuar, të përbërë nga prokurorë dhe policë që do ndjekin çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Periudha e planifikuar për këtë projekt është 2 vjet, në vazhdim të së cilës Shqipëria do të ketë mundësi:

a) të luftojë krimin e organizuar në mënyrë më efikase, veçanërisht trafikun e personave dhe kontrabandën;

b) të kontrollojë më mirë kufijtë e saj;

c) të zbulojë, hetojë dhe pengojë në mënyrë më të plotë korrupsionin;

d) të planifikojë buxhetin për programet e zbatimin e ligjit dhe të sigurojë që këto fonde po përdoren në mënyrë të rregullt, ligjore dhe efektive;

e) të menaxhojë rastet e krimeve në mënyrë më efikase brenda zyrave të PSH-së dhe zyrave të Prokurorisë dhe të identifikojë skemat e aktiviteteve kriminale; dhe

f) të ofrojë trainime me kualitet më të lartë për rekrutët e rinj në polici.

Kushti i financimit të grantit nga QSHB-ja përtej vitit aktual fiskal varet nga progresi i kënaqshëm në drejtim të qëllimeve të projektit dhe mundësisë së fondeve të autorizuara dhe të caktuara mbi bazën e vit-mbas-viti nga Kongresi i SHB-së, dhe të aprovuar nga Departamenti i Shtetit të SHB-së, Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit dhe Narkotikëve (INL).

III. Qëllimi i projektit dhe verifikimi i arritjeve

Qëllimet specifike të këtij projekti janë:

- në mënyrë bilaterale dhe në bashkëpunim me përpjekje të tjera ndërkombëtare të rrisë kapacitetin e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të forcuar zbatimin e ligjit;

- të profesionalizojë forcat e Policisë Shqiptare për t'i bërë ato më efektive dhe të bazuara;

- të vendosë një sistem menaxhimi të zbatimit të ligjit në nivelin qendror dhe në çdo prefekturë; dhe

- të mundësojë policinë kufitare shqiptare për të kontrolluar më me efikasitet kufijtë e Shqipërisë për të ndaluar dhe zbuluar trafikun e personave dhe kontrabandën; dhe

- të ngrejë një task forcë kundër krimit të organizuar të përbërë nga prokurorë dhe policë për të

ndjekur çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Shqipëri.

Progresi drejt arritjes së këtyre qëllimeve të projektit do të matet me përmirësimet e vazhdueshme në nivelin e ekspertizës profesionale të policisë, hetimit të brendshëm dhe masave të kuptimta disiplinore të lidhura me korrupsionin në polici, një hetim dhe ndjekje penale më të madhe dhe të mirë ndaj aktivitetit të krimit të organizuar, përfshirë trafikimin e qenieve të gjalla marrëdhënieve dhe bashkëpunim të përmirësuar midis policisë dhe prokurorisë, dhe përmirësimet në cilësinë e mësimdhënies në Akademinë e Policisë.

Metodat e verifikimit të arritjeve të projektit përfshijnë vëzhgimin nga personeli i të dy qeverive bashkëpunuese dhe rishikimin e të dhënave zyrtare të veprimeve legjislative dhe administrative, hetimet e policisë dhe ndjekjet penale.

IV. Dispozita standarde

1. Financimi

A. Lëvrimi i fondeve të QSHB-së për blerjen e mallrave dhe shërbimeve do të bëhet si pagesë në bazë të dokumenteve nënobliguese të përgatitura dhe lëshuara nga Ambasada Amerikane ose INL-ja.

B. Fondet e obliguara nga Shtetet e Bashkuara që nuk janë nënobliguar brenda dymbëdhjetë muajve mbas mbylljes së vitit fiskal të Qeverisë së SH.B-së në të cilin Marrëveshja është nënshkruar mund të hiqen nga QSHB-ja. Një zgjatje e periudhës së nënobligimit mund të ofrohet mbas një kërkese bërë Departamentit të Shtetit të SHB-së, INL-së.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë veprimin efektiv nga dita në ditë të Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, duke ofruar fonde adekuate për shpenzime normale administrative ose të lidhura me to, si pagesa qiraje dhe pajisjesh, kosto telefonash, rrogat dhe përfitimet, përfshirë edhe sigurimet shëndetësore ose sigurime të tjera, duke punësuar dhe mbajtur në punë personel kompetent. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të bëjë përpjekje të tilla të arsyeshme që janë të nevojshme për të siguruar që fondet ose ndihmesa tjetër e dhënë nën këtë Marrëveshje të mos përdoret, në mënyrë të tillë që të ndihmojë në trafikun e drogës.

2. E drejta

E drejta për të gjithë pasuritë ndërmjet financimit nga QSHB-ja do të bëhet për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe.

3.Pasuritë dhe Personeli

A. Pasuritë

Pasuritë e dhëna Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ndërmjet financimit nga QSHB-ja do t'i kushtohen projektit dhe, si pasojë, do të përdoren për të çuar më tej objektivat e projektit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakort për t'i kthyer QSHB-së ose për t'i rimbursuar QSHB-së për çdo lloj pasurie që ajo përfton si rezultat i financimit nga QSHB, e cila nuk përdoret në lidhje me këtë predispozitë. Fondet që rrjedhin nga shitja e ndonjë pasurie të ofruar nga QSHB-ja në projekt do të përdoren në zbatimin e objektivave të projektit.

Të gjitha pajisjet, furnizimet dhe materialet do të llogariten ndaj Ambasadës Amerikane nga përdoruesi i fundit në një mënyrë jo më pak rigoroze se sa në rastin kur pajisjet, furnizimet dhe materialet do të ishin siguruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me fondet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

B. Personeli

Përpara se bursat, shoqëritë ose trainimi i pjesëmarrësve për personelin i propozuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë mund të financohen nën këtë Marrëveshje, personeli i propozuar për trainim duhet të paraqesë një certifikatë, siç përshkruhet në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, që ato nuk janë ndjekur penalisht për marrje me drogë ose nuk janë përfshirë në trafik droge në dhjetë vjetët e fundit.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakort për të mbajtur personelin që ka marrë trainim të financuar nën këtë Marrëveshje për një minimum prej dy vjetësh mbas përfundimit të këtij trainimi. Kjo kërkesë mund të bjerë nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të përfaqësuesve të përshtatshëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe QSHB-së.

4. Monitorimi dhe vlerësimi

Secila Palë do të ketë të drejtën: 1. të ekzaminojë çdo lloj pasurie të blerë nëpërmjet ose të financiar nga ajo Palë nën këtë projekt për të përcaktuar se një pasuri e tillë po përdoret në përputhje

me kushtet e këtij projekti; dhe 2. të inspektojë dhe kontrollojë çdo të dhënë dhe llogari në lidhje me fondet, pasuritë ose shërbimet e kontraktuesve të ofruara nga ajo Palë nën këtë Marrëveshje për të përcaktuar që fondet, shërbime ose pasuri të tilla po përdoren në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Palët bien dakord për të monitoruar progresin e këtij projekti, së bashku dhe për të monitoruar përdorimin e pajisjeve dhe materialeve të projektit të paktën një herë në vit gjatë kohëzgjatjes së projektit. Secila Palë do të caktojë personelin e kualifikuar për të marrë pjesë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit.

Secila Palë do t'i ofrojë tjetrës informacionin e nevojshëm për të vlerësuar efikasitetin e veprimeve të projektit nën kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Në fund të projektit një raport përfundimi do të përpilohet si pjesë integrale e këtij procesi. Raporti i përfundimit do të përfshijë një përmbledhje të kontributeve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, një listë të aktiviteteve të zhvilluara, objektivat e arritur dhe të dhëna bazë të lidhura me to.

5. Ligjet e zbatueshme

Të dyja qeveritë do të shpenzojnë fondet dhe do të mbështesin operacionet e projektit, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme për qeveritë përkatëse.

Të gjitha mallrat dhe shërbimet e blera me fondet e QSHB-së do të blihen dhe dërgohen nga Shtetet e Bashkuara, përveç në rastet kur vendoset ndryshe në këtë Marrëveshje ose kur autorizohet nga QSHB-ja.

6. Këmbimi i monedhave

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrë të tilla masa që do të jenë të domosdoshme për të siguruar që fondet e sjella në Shqipëri nga QSHB-ja për qëllimin, pronësimet të detyrimit që QSHB-ja ka nën këtë Marrëveshje që të këmbehen në monedhën e vendit pritës në kursin më të lartë i cili në kohën e këmbimit nuk është i jashtligjshëm.

7.Taksat

A.. Materialet dhe pajisjet

Çdo fond, material ose pajisje e sjellë në Shqipëri nga QSHB-ja, në pajtim të kësaj Marrëveshjeje, do të përjashtohet nga taksat, detyrimet e shërbimit dhe investimit ose kërkesat e depozitave ose kontrolli i monedhave në Shqipëri dhe importi, eksporti, përfitimi, përdorimi ose transferimi i kësaj pasurie ose fondi në lidhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohet nga çdo lloj tarife, takse doganore, takse importi ose eksporti, takse mbi blerjet ose transferimin dhe çdo lloj takse ose pagese të ngjashme në Shqipëri.

B. Shërbimet kontraktuale

Çdo kontraktor i huaj, duke përfshirë çdo kompani konsultimi dhe çdo personel i huaj i një kontraktori të tillë të financuar nën këtë projekt dhe çdo pasuri ose transaksion i lidhur direkt me këto kontrata, dhe çdo lloj transaksioni për blerjen e mallrave të financuar nën këtë projekt është i përjashtuar nga taksa, tarifa, pagesa dhe detyrime të identifikueshme të imponuara nga ligji që është në fuqi në Shqipëri.

8. Statusi i personelit të QSHB-së në Shqipëri

Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakord të presë personat e caktuar nga QSHB-ja për të kryer përgjegjësinë e QSHB-së në këtë Marrëveshje. Me vënien në dijeni nga QSHB-ja, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i ofrojë këtyre personave privilegjet dhe imunitetin që i ofrohet Stafit Teknik dhe Administrativ të QSHB-së dhe i caktuar për ambasadën e SHB-së, përveç rasteve kur jepet ndryshe në këtë Marrëveshje.

I gjithë personeli në QSHB i caktuar në detyrë në Shqipëri në lidhje me programet dhe projektet e asistencës bashkëpunuese/teknike dhe anëtarët që shoqërojnë familjet e tyre do të përjashtohen nga çdo taksë mbi të ardhurat ose taksa të sigurimit shoqëror shqiptar në lidhje me të ardhurat e marra gjatë kohës që janë në Shqipëri dhe nga taksat mbi pasurinë vetiake që është për përdorim personal. Ky personel dhe anëtarët e familjeve të tyre do të marrin të njëjtin trajtim përsa i përket pagesës së doganës ose detyrimet e importit mbi mjetet personale, pajisje ose furnizime të importuara në Shqipëri për përdorimin nga ana e tyre, ashtu siç i është akorduar trupit diplomatik të ambasadës së SHB-së në Shqipëri nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

9. Të drejtat e njeriut

Palët njohin dhe bien dakord që mbrojtja e të drejtave të njeriut është një element i rëndësishëm i kësaj Marrëveshje dypalëshe. Për këtë qëllim, Palët kuptojnë dhe bien dakord që:

- asistenca e QSHB-së për përpjekjen e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të kontrolluar krimin kushtëzohet nga mbrojtja aktive e të drejtave të njeriut në Shqipëri nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe

- në përputhje me ligjin dhe politikën e Shteteve të Bashkuara, asnjë asistencë ose fondi i QSHB-së nuk mund të jepet nën këtë Marrëveshje për përdorim të ndonjë reparti të forcave të sigurisë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në qoftë se Sekretari i Shtetit të SHB-së ka prova të besueshme që një repart i tillë ka ndërmarrë shkelje të hapura të të drejtave të njeriut, përveçse kur Sekretari i Shtetit të SHB-së vendos se Qeveria e Republikës së Shqipërisë po ndërmerr masa efektive për të dërguar personat përgjegjës të këtyre forcave të sigurisë përpara drejtësisë. Palët kuptojnë dhe bien dakord që "masa efektive" do të thotë që Qeveria e Republikës së Shqipërisë po ndërmerr një hetim të besueshëm dhe se individët e përfshirë do të përballen me masa përkatëse disiplinore ose ndjekje penale të paanshme, në përputhje me ligjin vendas.

10. Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të aplikohet provizorisht qysh nga data e nënshkrimit të saj dhe do të hyjë në fuqi përfundimisht me marrjen e një njoftimi me shkrim nga ana e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për QSHB-së se procedurat e brendshme të aprovimit kanë përfunduar për të çuar marrëveshjen drejt zbatimit përfundimtar.

Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë Palës tjetër një lajmërim të shkruar 90 ditë përpara. Përfundimi i kësaj Marrëveshje anulon çdo obligim të të dyja Palëve për të kontribuar në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç rastit të pagesave për angazhimet e marra ndaj Palëve të treta, përpara se të bëhej lajmërimi për anulimin e kësaj Marrëveshje.

QSHB-ja rezervon të drejtën për të përfunduar çdo lloj dhe të gjithë asistencën e ofruar nën këtë Marrëveshje, duke lajmëruar për këtë ose të marrë masat e duhura, në qoftë se një agjenci e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nëpërmjet të cilës ose për të cilën kjo asistencë ofrohet nën këtë Marrëveshje ose një individ kyç i kësaj agjencie ose një përfitues i një burse, shoqërie ose trainimi i financuar nën këtë Marrëveshje gjendet të ketë qenë dënuar për një krim të lidhur me drogën ose të ketë qenë përfshirë në trafikun e drogës të përcaktuar në nenin 22 CFR pjesa 140.

Kuptohen posaçërisht që detyrimet e paragrafit 3 të kësaj Marrëveshje në lidhje me përdorimin e pasurisë mbeten në fuqi mbas përfundimit të kësaj Marrëveshje.

Bërë në dublikate në Tiranë, Shqipëri më 10 janar 2002, në gjuhët angleze dhe shqip, të dy tekstet janë autentikisht të barabartë.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara
Skënder Gjinushi Zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë	Elizabeth W.Shelton e ngarkuara me Punë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

L I G J
Nr. 8865, datë 14.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit" e datës

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3272, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA
NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Kombet e Bashkuara
1999
Preambula
Shtetet Anëtare të kësaj Konvente,

Duke pasur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve të mira të fqinjësisë, të miqësisë dhe bashkëpunimin midis Shteteve,

Të shqetësuar thellësisht për zhvillimin mbarëbotëror të akteve të terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij,

Duke kujtuar Deklaratën me rastin e përvjetorit të pesëdhjetë të Kombeve të Bashkuara, të përfshirë në Rezolutën 50/6 të Asamblesë së Përgjithshme të 24 tetorit 1995,

Duke kujtuar, gjithashtu, të gjitha rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme që kanë lidhje me çështjen, përfshirë këtu Rezolutën 49/60 të 9 dhjetorit 1994 dhe shtojcën e saj në Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, në të cilën Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara riafirmojnë solemnisht dënimin e tyre pa ekuivok të të gjitha akteve, metodave dhe praktikave të terrorizmit si kriminale dhe të pajustifikueshme, të kryera kudo dhe nga kushdoqoftë, përfshirë ato që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore mes Shteteve dhe popujve dhe kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurisë e Shteteve,

Duke vënë në dukje se Deklarata mbi Masat për Eleminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar i nxiti Shtetet për të riparë urgjentisht gamën e akteve ekzistuese ligjore ndërkombëtare mbi parandalimin, shtypjen dhe eleminimin e terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij, me qëllimin e sigurimit të ekzistencës së një kuadri tërësor ligjor që mbulon të gjitha aspektet e çështjes,

Duke kujtuar Rezolutën 51/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, paragrafin 3 të saj, nënparagrafin (f), në të cilën Asambleja u bëri thirrje të gjitha Shteteve të marrin masat për të parandaluar dhe kundërvepruar, përmes masave përkatëse nga secili Shtet, financimin e terroristëve dhe organizatave terroriste, pavarësisht nga fakti nëse financimi bëhet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt përmes organizatave që kanë ose pretendojnë se kanë qëllime bamirësie, sociale ose kulturore, ose të cilat janë gjithashtu të përfshira në aktivitete joligjore, të tilla si trafikimi i paligjshëm i armëve, drogës dhe i parave nga burime të papastra, përfshirë këtu shfrytëzimin e personave për qëllime të financimit të aktiviteteve terroriste, dhe, në veçanti, për të marrë në konsideratë, kur shihet e përshtatshme, përshtatjen e masave rregullatore për të mos lejuar dhe kundërvepruar ndaj lëvizjes së fondeve të dyshuara që mund të përdoren për qëllime terroriste pa penguar në asnjë mënyrë lirinë e lëvizjeve legjitime të kapitalit dhe për të intensifikuar shkëmbimin e informacionit lidhur me lëvizjet ndërkombëtare të këtyre fondeve,

Duke kujtuar gjithashtu Rezolutën 52/165 të 15 dhjetorit 1997, të Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën Asambleja u bëri thirrje Shteteve të merrnin parasysh posaçërisht zbatimin e masave të përshkruara në paragrafet 3 (a) deri në (f) të Rezolutës së saj 51/210 të 17 dhjetorit 1996,

Duke kujtuar më tej Rezolutën 53/108 të 8 dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi që Komiteti Ad Hoc i themeluar mbi bazën e Rezolutën 52/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, duhej të përpunonte draftin e një konvente ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit, i cili t'i shtohej instrumenteve ndërkombëtare përkatëse ekzistuese,

Duke kujtuar gjithashtu Rezolutën 52/165 të 15 dhjetorit 1997, të Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën Asambleja u bëri thirrje Shteteve të merrnin parasysh posaçërisht zbatimin e masave të

përshkruara në paragrafët 3 (a) deri në (f) të Rezolutës së saj 51/210 të 17 dhjetorit 1996,

Duke kujtuar më tej Rezolutën 53/108 të 8 dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi që Komiteti Ad Hoc i themeluar mbi bazën e Rezolutës 51/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, duhej të përpunonte draftin e një konvente ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit, i cili t'i shtohej instrumenteve ndërkombëtare përkatëse ekzistuese,

Duke pasur parasysh se financimi i terrorizmit përbën një shqetësim të rëndë për komunitetin ndërkombëtar në tërësi,

Duke vënë në dukje se numri dhe serioziteti i akteve të terrorizmit ndërkombëtar varet nga financimi që terroristët munden të sigurojnë,

Duke vënë në dukje se instrumentet legale ekzistuese multilaterale nuk e përmendin shprehimisht një financim të tillë,

Duke qenë të bindur për nevojën urgjente të intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis Shteteve në sajimin dhe përshtatjen e masave efektive për parandalimin e financimit të terrorizmit, si edhe të luftës kundër tij përmes ndjekjes dhe ndëshkimit të fajtorëve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Fonde" ka kuptimin e aseteve të çdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë vënë, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo forme, përfshirë këtu mjete elektronike ose dixhitale, që dëshmojnë të drejtat ose interesin në asete të tilla, si kredi bankare, çeqe udhëtarësh, çeqe bankare, mandatpagesa, aksione, siguracione, bono, urdhërpagesa, letra krediti.

2. "Mjet shtetëror ose qeveritar" ka kuptimin e një mjeti të përhershëm ose të përkohshëm ose të një autorizimi që përdoret ose shtihet në dorë nga përfaqësues të Shtetit, anëtarë të qeverisë, zyrtarë të legjislativit ose të gjyqësorit ose punonjës të shtetit ose të ndonjë autoriteti tjetër publik ose të ndonjë institucioni, ose nga punonjës apo zyrtarë të një organizate ndërqeveritare dhe që ka lidhje me përgjegjësitë e tyre zyrtare.

3. "Të ardhura" konsiderohen të gjitha ato fonde që rrjedhin nga ose janë siguruar drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes kryerjes së një shkeljeje të përmendur në nenin 2.

Neni 2

1. Sipas kësaj Konvente, çdo person konsiderohet se kryen një shkelje nëse ai direkt ose indirekt, në mënyrë të paligjshme dhe me dëshirë, siguron ose grumbullon fonde me synimin që ato të përdoren ose ka dijeni se ato do të përdoren plotësisht ose pjesërisht për të kryer:

(a) një veprim që përbën një shkelje brenda kuadrit të shkeljeve të përcaktuara në një prej traktateve të listuara tek aneksi; ose

(b) çdo akt tjetër që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen ose plagosje të rëndë trupore të një civili ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në armiqësitë e situatave të një konflikti të armatosur, kur qëllimi i një veprimi të tillë nga natyra ose konteksti është ta frikësojë popullatën ose ta detyrojë qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të mos e kryejë një veprim.

2. (a) Me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të hyrjes në fuqi, një Shtet Anëtar, i cili nuk është anëtar i atij traktati të përmendur në aneks, mund të deklarojë mospërfshirjen e tij në aneksin të cilit i referohet paragrafi 1 nënparagrafi a. Kjo deklaratë do të shfuqizohet sapo traktati të hyjë në fuqi për Shtetin Anëtar, i cili njofton depozitimin e këtij instrumenti.

(b) Kur një Shtet Anëtar heq dorë nga anëtarësia në traktatin e përmendur në aneks, ai mund të bëjë një deklaratë në lidhje me këtë traktat, siç thuhet në këtë nen.

3. Që një akt të përbëjë një krim, të parashtruar në paragrafin 1, nuk është patjetër e nevojshme që fondet të jenë përdorur për të kryer një shkelje të përmendur në paragrafin 1 nënparagrafi (a) ose (b).

4. Çdo person konsiderohet se ka kryer krim, nëse ai përpiqet të kryejë njërën prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Çdo person kryen një krim nëse ai:

(a) merr pjesë si bashkëpunëtor në njërën prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni;

(b) organizon ose udhëheq të tjerët për të kryer njërin prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni;

(c) kontribuon në kryerjen e një ose të më shumë veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni, kur këto vepra kryhen nga një grup personash, që kanë një qëllim të përbashkët. Një kontribut i tillë do të jetë i qëllimshëm dhe do të kryhet:

(i) ose për të çuar më tej aktivitetin ose qëllimin kriminal të grupit ku një qëllim ose veprim i tillë përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni;

(ii) ose duke patur dijeni për qëllimin e grupit, i cili kryen njërin nga krimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 3

Kjo Konventë nuk zbatohet kur krimi kryhet brenda një Shteti të vetëm kur shkelësi është nënshtetas i atij vendi dhe është prezent në territorin e atij dhe asnjë Shtet tjetër sipas nenit 7 paragrafit 1 ose nenit 7 paragrafit 2 nuk kanë të drejtë të ushtrojnë juridiksionin e vet, me përjashtim të rasteve të parashikuara në dispozitat e neneve 12-18.

Neni 4

Çdo Shtet Anëtar duhet të adaptojë masa të tilla të domosdoshme:

(a) t'i konsiderojë si akte kriminale sipas ligjeve të vendit veprat e parashikuara në nenin 2.

(b) t'i shpallë këto vepra të dënueshme nëpërmjet dënimeve të përshtatshme, dënime të cilat duhen të marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave.

Neni 5

1. Çdo Shtet Anëtar, në përputhje me ligjet e veta në fuqi, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të bërë të mundur që një person juridik brenda territorit të këtij Shteti ose i organizuar sipas ligjeve të tij, të mbajë përgjegjësi kur një person përgjegjës për menaxhimin ose kontrollin e atij personi juridik ka kryer një prej veprave të parashikuara në nenin 2. Përgjegjësia e mbajtur do të jetë penale, civile ose administrative.

2. Një përgjegjësi e tillë duhet të mos cenojë përgjegjësinë kriminale të individit që ka kryer krimet.

3. Çdo Shtet Anëtar duhet të garantojë që këta persona juridikë, sipas paragafit 1 më sipër, t'i nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale penale, civile ose administrative. Këtu mund të përfshihen edhe sanksionet monetare.

Neni 6

Çdo Shtet Anëtar duhet të adaptojë masa të tilla të nevojshme, përfshirë këtu legjislacionin vendas, për të siguruar që aktet kriminale të përmendura në këtë Konventë nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë me arsye politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare ose të natyrave të ngjashme me to.

Neni 7

1. Çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për të ushtruar juridiksionin e vet ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2 kur:

(a) krimi është kryer në territorin e atij Shteti;

(b) krimi është kryer në bordin e një anijeje që mban flamurin e atij Shteti ose në bordin e një aeroplani të regjistruar sipas ligjeve të atij Shteti në kohën kur është kryer krimi;

(c) krimi kryhet nga një nënshtetas i atij Shteti.

2. Një Shtet Anëtar mund të ushtrojë juridiksionin e vet ndaj një krimi edhe kur:

(a) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b drejtohet ndaj një shtetasi të atij Shteti ose kur rezulton i kryer në territorin e atij Shteti;

(b) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, është drejtuar kundër Shtetit ose kundër një ndërtese qeveritare të atij Shteti jashtë, duke përfshirë këtu përfaqësitë diplomatike ose konsullore të atij Shteti;

(c) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, ka ardhur si rezultat i një përpjekjeje për ta detyruar atë shtet të kryejë ose jo një veprim;

(d) krimi kryhet nga një person pa shtetësinë e atij Shteti, ndërkohë që jeton në atë Shtet;

(e) krimi kryhet në bordin e një aeroplani, i cili është në funksion të atij Shteti.

3. Me ratifikimin, pranimin, miratimin, ose me anëtarësimin në këtë Konventë, çdo Shtet Anëtar duhet të njoftojë sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për juridiksionin që ai ka vendosur në përputhje me paragrafin 2. Nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim, Shteti Anëtar përkatës duhet të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Po ashtu çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për të ushtruar juridiksionin e vet ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2 edhe në rastet kur i dyshuari për krim është prezent në territorin e atij Shteti dhe ai Shtet nuk e ekstradon atë person në ndonjë prej Shteteve Anëtare, që e kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafët 1 ose 2.

5. Kur më shumë sesa një Shtet Anëtar pretendon të ketë juridiksionin ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2, atëherë këto Shtete Anëtare duhet të përpiqen t'i koordinojnë si duhet veprimet e tyre, veçanërisht të sigurojnë kushtet për hetim dhe modalitetet për asistencë reciproke ligjore.

6. Pa cenuar normat e ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar, kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e një juridiksioni kriminal të një Shteti Anëtar në lidhje me ligjet e veta të brendshme.

Neni 8

1. Secili Shtet Anëtar do të marrë masat e nevojshme në përputhje me parimet ligjore të vendit të vet, për identifikimin, zbulimin, dhe ngrirjen ose kapjen e çdo fondi të përdorur ose të caktuar për të kryer krimet e përshkruara në nenin 2, si edhe të ardhurat prej krimesh të tilla me qëllim të mbajtjes së mundshme të shumave.

2. Secili Shtet Anëtar do të marrë masat e nevojshme, në përputhje me parimet ligjore të vendit të vet për mbajtjen e fondeve të përdorura ose të caktuara për të kryer krimet e përshkruara në nenin 2, si edhe të ardhurat e rrjedhura prej krimesh të tilla.

3. Secili Shtet Anëtar, i interesuar, mund të marrë në konsideratë hartimin e marrëveshjeve me Shtete të tjera Anëtare për të përdorur bashkërisht e rast pas rasti fondet e krijuara prej mbajtjeve nga llogaritë e bllokuara që përmenden në këtë nen.

4. Secili Shtet Anëtar duhet të marrë në konsideratë ndërtimin e mekanizmave me anë të të cilave fondet e krijuar nga mbajtjet e llogarive të bllokuara të përmendura në këtë nen, të përdoren për të zhdëmtuar viktimat e krimeve të përmendura në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, ose familjet e tyre.

5. Dispozitat e këtij neni duhet të zbatohen pa cenuar të drejtat e Palëve të treta që veprojnë në mirëbesim.

Neni 9

1. Me të marrë informacionin se një person që e ka kryer një krim ose që supozohet ta ketë kryer atë krim, të përmendur në nenin 2, mund të jetë prezent në territorin e vet, Shteti Anëtar përkatës duhet të marrë masat e nevojshme sipas ligjeve të vendit të vet për të hetuar faktet që përmbahen në informacionin e dhënë.

2. Me t'u kënaqur me informacionin dhe me faktin se rrethanat e lejojnë, Shteti Anëtar, në territorin e të cilit ndodhet krimineli ose i akuzuari për krim, duhet të marrë masat përkatëse sipas ligjeve të vendit të vet në mënyrë që të garantojë prezencën e personit për qëllimet e ndjekjes dhe të ekstradimit.

3. Çdo person, ndaj të cilit janë marrë masat e përmendura në paragrafin 2, duhet të ketë të drejtë të:

(a) komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin përkatës më të afërt të Shtetit, shtetësinë e të cilit ai mban, ose i cili ka të drejtën t'i mbrojë të drejtat e atij personi, ose nëse ai person është banor i atij shteti pa qenë shtetas i tij;

(b) kontaktohet nga një përfaqësues i atij Shteti;

(c) informohet për të drejtat që gëzon sipas nënparagrafëve a dhe b.

4. Të drejtat e përmendura në paragrafin 3 duhet të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e Shtetit, në territorin e të cilit krimineli ose i akuzuari për krim është prezent. Kjo duhet të bëhet në përputhje me dispozitën, sipas së cilës ligjet dhe rregullat e mësipërme duhet të sigurojnë arritjen e qëllimeve, të cilave iu shërbejnë të drejtat e akorduara në paragrafin 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 duhet të mos cenojnë të drejtën e çdo Shteti Anëtar të kërkojë juridiksionin e vet në përputhje me nenin 7 paragrafin 1, nënparagrafin b ose paragrafin 2, nënparagrafin b, për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të komunikuar me dhe për të vizituar të akuzuarin për krim.

6. Sipas këtij neni, kur një Shtet Anëtar ka marrë një person nën mbikëqyrje, ai duhet të njoftojë menjëherë direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Shtetet Anëtare, të cilat kanë vendosur juridiksionin siç përshkruhet në nenin 7 paragrafi 1 ose 2 dhe nëse ai e konsideron të arsyeshme mund të njoftojë edhe Shtete të tjera Anëtare të interesuara që personi në fjalë është nën mbikqyrje dhe për rrethanat në të cilat ai mbahet i ndaluar. Shteti që heton faktet e përmendura me hollësi në paragrafin 1 duhet të informojë menjëherë Shtetet Anëtare, si më sipër, për rezultatet e hetimit dhe duhet të tregojë nëse ai synon të ushtrojë juridiksionin e vet.

Neni 10

1. Shteti Anëtar, në territorin e të cilit ndodhet i akuzuari për krim, në rastet që parashikohen në nenin 7, duhet që, nëse nuk e ekstradon atë person, të jetë i detyruar pa përjashtim ta kalojë rastin për hetim pa asnjë vonesë tek autoritetet kompetente sipas procedurave të ligjeve të atij Shteti. Kjo duhet të ndodhë pavarësisht nga fakti nëse krimi është kryer ose jo në atë Shtet. Autoritetet e Shtetit duhet t'i marrin vendimet në të njëjtën mënyrë, si edhe në rastin e një krimi shumë të rëndë, në përputhje me ligjet e atij Shteti.

2. Sa herë që Shteti Anëtar lejohet nga ligji i vendit të vet të ekstradojë ose të dorëzojë njërin prej shtetasve të vet vetëm me kushtin që personi t'i kthehet sërisht Shtetit për të vuajtur dënimin e dhënë si rezultat i një gjyqi ose procedure për të cilën ishte kërkuar ekstradimi ose dorëzimi i personit; sa herë që ky Shtet dhe Shteti që kërkon ekstradimin e personit merren vesh për këtë variant dhe për kushtet e tjera që ata i gjykojnë të përshtatshme, atëherë një ekstradim ose dorëzim i tillë me kushte, duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u çliruar nga detyrimi i përmendur në paragrafin 1.

Neni 11

1. Krimet e përmendura në nenin 2 duhet të gjykohen për t'u përfshirë si krime të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që ekziston midis çdonjërit prej Shteteve Anëtare para se kjo Konventë të hyjë në fuqi. Shtetet Anëtare marrin përsipër t'i përfshijnë krime të tilla si krime të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që arrihet midis tyre.

2. Kur një Shtet Anëtar që bën një ekstradim mbi bazën e një traktati ekzistues merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Anëtar, me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, Shtetit Anëtar të cilit i bëhet kërkesa, po të dojë e konsideron këtë Konventë si një bazë ligjore për ekstradimin e rasteve të krimeve të parashikuara në nenin 2. Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet edhe kërkesave të tjera të ligjit të Shtetit të cilit i është kërkuar ekstradimi.

3. Shtetet Anëtare që nuk kanë marrëveshje për të bërë ekstradim me kushte duhet të njohin krimet e parashikuara në nenin 2 si krime të ekstradueshme midis këtyre Shteteve dhe kjo bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit të Shteit të cilit i është kërkuar ekstradimi.

4. Krimet e parashikuaraa në nenin 2 duhet të trajtohen, nëse është e nevojshme për qëllime ekstradimi midis Shteteve Anëtare, jo vetëm si krime të kryera në vendin ku janë kryer, por gjithashtu edhe si krime të kryera në territorin e Shteteve që kanë ndërtuar juridiksione në përputhje me nenin 7

paragrafët 1 dhe 2.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve midis Shteteve Anëtare mbi ekstradimin e personave për krimet e përshkruara në nenin 2 duhet të gjykohen për t'u modifikuar si traktate dhe marrëveshje midis Shteteve Anëtare deri në atë shkallë sa të harmonizohen me këtë Konventë.

Neni 12

1. Shtetet Anëtare duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të madhe të ndihmës në lidhje me hetimet kriminale ose procedurat kriminale ose procedurat e ekstradimit për krimet e përshkruara në nenin 2, përfshirë këtu ndihmën për sigurimin e të dhënave që i posedon Pala tjetër dhe që janë të nevojshme për procedimin e mëtejshëm.

2. Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë ta refuzojnë kërkesën për ndihmë ligjore reciproke, duke nxjerrë si pretekst ruajtjen e sekretit.

3. Pala që kërkon ndihmë nuk duhet ta transmetojë ose ta përdorë informacionin ose faktet me të cilat është furnizuar nga Pala tjetër për hetime, ndjekje ose procedura të ndryshme nga ato që janë formuluar në kërkesë, pa miratimin paraprak të Palës ndihmuese.

4. Çdonjëri prej Shteteve Anëtare kanë të drejtë të marrë në konsideratë ndërtimin e mekanizmave për të shkëmbyer me Shtetet e tjera Anëtare informacionin ose faktet e nevojshme për të kërkuar mbajtjen e përgjegjësisë kriminale, civile e administrative siç përshkruhen në nenin 5.

5. Shtetet Anëtare duhet të realizojnë detyrimet që rrjedhin nga paragrafët 1 dhe 2, konform çdo traktati dhe marrëveshjeje tjetër ekzistuese midis tyre për ndihmën ligjore reciproke dhe për shkëmbimin e informacionit. Në mungesë të traktateve dhe të marrëveshjeve të tilla, Shtetet Anëtare duhet t'i japin ndihmë njëri-tjetrit në përputhje me ligjet e vendeve të veta.

Neni 13

Asnjëri nga krimet e përshkruara në nenin 2 nuk duhet të shihet si një krim financiar kur është fjala për ekstradimin ose ndihmën ligjore reciproke. Po ashtu, Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë të refuzojnë një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë ligjore reciproke vetëm sepse krimi ka natyrë financare.

Neni 14

Asnjëri nga krimet e përshkruara në nenin 2 nuk duhet të shihet si një krim politik ose si një krim i lidhur me një krim politik ose si një krim i frymëzuar nga motive politike. Po ashtu një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë ligjore reciproke, e bazuar në një krim të tillë, nuk është mirë të refuzohet vetëm sepse krimi është politik ose sepse krimi është i lidhur me një krim politik ose sepse krimi është frymëzuar nga motive politike.

Neni 15

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të intepretohet si imponim i detyrimit për të ekstraduar ose për të ofruar ndihmë ligjore reciproke, në qoftë se Shteti Anëtar të cilit i është kërkuar kjo gjë, ka arsye thelbësore të besojë se kërkesa për ekstradim për krimet e përshkruara në nenin 2 ose kërkesa për ndihmë ligjore reciproke që lidhet me krime të tilla ka qenë paraqitur me synim persekutimin ose ndëshkimin e një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose opinionit politik. Kjo vlen edhe për rastin kur pranimi i kërkesës mund të shkaktojë dëmtimin e pozitës së personit për çdonjërin prej këtyre shkaqeve.

Neni 16

1. Ku një person që është ndaluar ose që vuan një dënim në territorin e një Shteti Anëtar, kërkohet prej një Shteti tjetër Anëtar të jetë prezent në këtë të fundit për qëllime identifikimi, dëshime ose për të ofruar ndihmë në sigurimin e të dhënave për hetim ose ndjekje të krimeve siç përshkruhen në nenin 2, atëherë ai mund të transferohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

(a) Personi e pranon lirisht e me vetëdije këtë gjë.

(b) Autoritetet kompetente të të dy Shteteve bien dakord për kushtet të cilat i gjykojnë të përshtatshme vetë Shtetet.

2. Në funksion të qëllimeve të këtij neni:

(a) Shteti në të cilin personi transferohet duhet të ketë autoritetin dhe detyrimin ta mbajë personin e transferuar nën mbikqyrje, nëse nuk kërkohet dhe nuk autorizohet gjë tjetër nga Shteti prej të cilit personi u transferua;

(b) Shteti në të cilin personi transferohet duhet që, pa vonesë, të zbatojë detyrimin e vet për ta kthyer personin nën mbikqyrjen e Shtetit e nga i cili personi u transferua në bazë të marrëveshjes paraprake ose ashtu siç ishte ranë dakord nga autoritetet kompetente të të dyja Shteteve;

(c) Shteti në të cilin personi transferohet nuk duhet t'i kërkojë Shtetit nga i cili personi u transferua të fillojë procedurat ekstraduese për kthimin e personit;

(d) personit të transferuar duhet t'i njihet dënimi i vuajtur në Shtetin nga i cili ai/ajo u transferua si kohë e shpenzuar nën mbikqyrjen e Shtetit në të cilin ai/ajo transferohet.

3. Nëse Shteti Anëtar, nga i cili një person është për t'u transferuar në përputhje me këtë nen, nuk bie dakord, atëherë ai person pavarësisht nga kombësia e tij nuk duhet të ndiqet penalisht ose nuk duhet të ndalohet ose nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi të lirisë së tij personale në territorin e Shtetit në të cilin ai person transferohet për akte ose vepra që ai i ka kryer përpara largimit të tij nga territori i Shtetit, nga i cili ky person u transferua.

Neni 17

Çdo personi të vendosur nën mbikqyrje ose ndaj të cilit janë ndërmarrë masa të tjera ose janë kryer procedura në përputhje me këtë Konventë duhet t'i sigurohet trajtim i drejtë, përfshirë këtu të gjitha të drejtat dhe garancitë në përputhje me ligjin e Shtetit, në territorin e të cilit ky person është prezent, si edhe dispozitat e aplikueshme të ligjit ndërkombëtar, përfshirë këtu ligjin ndërkokmbëtar për të drejtat e njeriut.

Neni 18

1. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë për parandalimin e krimeve të parashikuara në nenin 2, duke marrë të gjitha masat e aplikueshme, ndër të tjera duke përshtatur legjislacionin e vendeve të veta, nëse kjo është e nevojshme, të parandalojnë dhe të kundërveprojnë në territoret përkatëse ndaj krimeve të kryera brenda ose jashtë territoreve të tyre, duke përfshirë:

(a) masat për të penguar në territoret e tyre aktivitetet e paligjshme të personave dhe organizatave që nxisin, provokojnë, organiziojnë ose përfshihen qëllimisht në kryerjen e krimeve të parashikuara në nenin 2;

(b) procedurat që u kërkojnë institucioneve financiare dhe profesioneve të tjera të përfshira në transaksione financiare të përdorin rrugët më efikase për identifikimin e klientëve të tyre të zakonshëm ose të rastit, si edhe klientë në interes të të cilëve janë hapur llogari bankare dhe t'i kushtojnë gjithashtu vëmendje të veçantë transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta dhe të raportojnë transaksionet, për të cilat ka dyshime se rrjedhin nga një aktivitet kriminal. Për këtë qëllim Shtetet Anëtare duhet të kenë parasysh:

(i) adaptimin e rregulave që pengojnë çeljen e atyre llogarive, zotëruesit ose përfituesit e të cilave janë të paidentifikuar ose të paidentifikueshëm dhe marrjen e masave që garantojnë që këto institucione të verifikojnë identitetin e pronarëve realë të transaksioneve të tilla;

(ii) që lidhur me identifikimin e entiteteve legale, që kërkojnë institucione financiare, të marrin masa kur është e nevojshme për verifikimin e ekzistencës ligjore dhe të strukturës së klientit, duke marrë ose nga ndonjë regjistër publik ose nga klienti apo nga të dy së bashku vërtetimet e hyrjeve, përfshirë këtu informacionin për emrin e klientit, gjendjen civile, adresën, drejtorët dhe dispozitat që rregullojnë institucionin;

(iii) kryerjen e rregullimeve që u imponojnë institucioneve financiare detyrimin për t'u raportuar menjëherë autoriteteve kompetente të gjitha transaksionet e mëdha, komplekse dhe të jashtëzakonshme, si edhe modelet e pazakonshme të transaksioneve që nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik e që duket se nuk janë ligjore, pa frikën se ngarkohen me përgjegjësi kriminale ose civile

për thyerjen e kufizimeve për daljen e informacionit, nëse ata i raportojnë dyshimet e tyre në mirëbesim;

(iv) t'u kërkojnë institucioneve financiare të ruajnë të paktën për pesë vjet të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për transaksionet brenda vendit dhe për ato ndërkombëtare.

2. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë në vijim për parandalimin e krimeve të përshkruara në nenin 2 duke patur parasysh:

(a) masat për mbikqyrjen, përfshirë p.sh. licencimin e të gjitha agjencive që bëjnë transferta parash;

(b) masa të përshtatshme për zbulimin ose monitorimin e transportit fizik ndërkufituar të parasë kesh dhe të transportuesve të instrumenteve, të cilat u nënshtrohen rregullave shumë strikte për të siguruar përdorimin e duhur të informacionit, pa penguar lëvizjen e lirë të kapitaleve.

3. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë në vijim për parandalimin e krimeve të përshkruara në nenin 2, duke shkëmbyer informacion të saktë dhe të verifikuar në përputhje me ligjin e vendit dhe duke koordinuar masat administrative dhe masat e tjera të marra ashtu siç duhet për të parandaluar kryerjen e krimeve të përshkruara në nenin 2, veçanërisht përmes:

(a) hapjes dhe mbajtjes së kanaleve të komunikimit midis agjencive dhe shërbimeve të tyre kompetente për të lehtësuar sigurimin e shkëmbimit të shpejtë të informacionit në lidhje me të gjitha aspektet e krimeve të përshkruara në nenin 2;

(b) bashkëpunimit me njëri-tjetrin dhe kryrjen e hetimeve për krime të përshkruara në nenin 2 lidhur me:

(i) identitetin, vendndodhjen dhe aktivitetet e personave për të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm për përfshirjen e tyre në krime të tilla;

(ii) Lëvizjen e fondeve lidhur me kryrjen e krimeve të tilla.

4. Shtetet Anëtare mund të shkëmbejnë informacion përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

Neni 19

Shteti Anëtar ku i akuzuari për krim ndiqet duhet që, në përputhje me ligjin e vendit të vet ose me procedurat që aplikohen, të komunikojë rezultatin përfundimtar të procedimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua transmetojë informacionin Shteteve të tjera Anëtare.

Neni 20

Shtetet Anëtare duhet t'i përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo Konventë në mënyrën që përputhet me parimet e sovranitetit, të barazisë dhe të integritetit territorial të Shteteve, si dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të Shteteve të tjera.

Neni 21

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të prekë të drejtat e tjera, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shteteve dhe të individëve që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar, në veçanti nga qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga ligji humanitar ndërkombëtar dhe nga konventa të tjera.

Neni 22

Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtë një Shteti Anëtar për të ndërmarrë në territorin e një Shteti tjetër Anëtar ushtrimin e juridiksionit ose kryerjen e funksioneve që u lejohen vetëm autoriteteve të Shtetit tjetër Anëtar nga ligji i vendit të vet.

Neni 23

1. Aneksi mund të amendohet duke shtuar në të traktate të lidhura me të që:

(a) janë të hapura për pjesëmarrjen e të gjitha Shteteve;

(b) kanë hyrë në fuqi;

(c) janë ratifikuar, pranuar ose miratuar nga të paktën njëzet e dy Shtete Anëtare të Konventës aktuale.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente çdo njëri prej Shteteve Anëtare mund të propozojë një amendament. Çdo propozim për një amendament duhet të depozitohet me shkrim. Arkivisti duhet t'ua njoftojë propozimet që i plotësojnë kërkesat e paragrafit 1 të gjitha Shteteve Anëtare dhe të kërkojë pikëpamjet e tyre, nëse amendamenti i propozuar duhet të adaptohet apo jo.

3. Amendamenti i propozuar duhet të gjykohet i adaptuar, nëse një e treta e Shteteve Anëtare nuk e kundërshtojnë atë me shkrim brenda 180 ditëve nga qarkullimi i saj.

4. Amendamenti i adaptuar në aneks duhet të hyjë në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit, të pranimit dhe të miratimit të amendamentit për të gjitha Shtetet Anëtare që e kanë depozituar një instrument të tillë. Për secilin nga Shtetet Anëtare që ratifikon, pranon ose miraton amendamentin pas depozitimit të instrumentit të njëzetedytë, amendamenti duhet të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga Shteti Anëtar i instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 24

1. Çdo diskutim midis dy ose më shumë Shteteve Anëtare lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Konvente që nuk zgjidhet përmes negociimeve brenda një kohe të arsyeshme duhet që me kërkesën e njërës prej Palëve të dërgohet për arbitrazh. Nëse brenda gjashtë muajsh nga data e kërkesës për arbitrazh Palët nuk janë të afta të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, çdonjëra prej këtyre Palëve ka të drejtë ta referojë diskutimin në Gjyqin Ndërkombëtar, duke aplikuar në përputhje me Statusin e Gjyqit.

2. Secili Shtet ka të drejtë që në kohën e nënshkrimit, të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit të kësaj Konvente ose të hyrjes së saj në fuqi, të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar të zbatojë paragrafin 1. Shtetet e tjera Anëtare nuk mund të detyrojnë asnjë Shtet tjetër Anëtar që ka shprehur një rezervë të tillë të ndjejë detyrimin e paragrafit 1.

3. Çdo Shtet që ka shprehur një rezervë në lidhje me paragrafin 2 ka të drejtë që në çdo kohë ta tërheqë atë rezervë me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 25

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet që prej 10 janarit 2000 deri në 31 dhjetor 2001 në Selinë e Kombeve në Nju Jork.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit të miratimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'i miratuar nga çdo Shtet. Instrumentet e miratimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 26

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzetedytë të ratifikimit, pranimit, ose miratimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Çdo Shtet që ratifikon, pranon, ose miraton Konventën pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga Shteti përkatës i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit.

Neni 27

1. Çdo Shtet Anëtar ka të drejtë ta denoncojë këtë Konventë me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi duhet të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 28

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të së cilës janë po aq identike, duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua dërgojë kopjet e certifikuara të gjitha Shteteve.

Të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar si duhet nga Qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork më 10 janar 2000.

Aneks

Konventa për Luftën ndaj Rrëmbimit të Paligjshëm të Aeroplanëve, e Hagës më 16 dhjetor 1970.

Konventa për Luftën ndaj Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, e Montrealit më 23 shtator 1971.

Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë diplomatët, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 14 dhjetor 1973.

Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkauar në 17 dhjetor 1979.

Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor, adaptuar në Vjenë në 3 mars 1980.

Protokolli për Luftën kundër Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i Shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, suplement i Konventës për Luftën kundër Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, në Montreal në 24 shkurt 1988.

Konventa për Luftën ndaj Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Oqeanik, në Romë në 10 mars 1988.

Protokolli për Luftën kundër Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Raftet Kontinentale, në Romë në 10 mars 1988.

Konventa Ndërkombëtare për Luftën kundër Bombardimeve Terroriste, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 15 dhjetor 1997.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 4.4.2002
Doli nga shtypi më 5.4.2002

Tirazhi: 4200 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë